



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “NDREGJONI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K31329048I, me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANE, Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8.**

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-55678-01-06-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikualifikim urban i Bllokut “Lagje e re”, me fond limit në vlerën: 27 617 117 (njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2023 në vlerën: 5 525 000 (pesë milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH, nga grandit i bashkisë: 3 845 000 (tre milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 1 680 000 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, për vitin 2024 në vlerën: 7 200 000 (shtatë milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH, nga grandit i bashkisë: 3 975 000 (tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 3 225 000 (tre milion e dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 14 892 117 (katërmëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, nga grandit i bashkisë: 7 450 000 (shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 7 442 117 (shtatë milion e katërqind e dyzet e dy mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me afat realizimi: 6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 4, datë 16 Janar 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **Operatori Ekonomik: “EURO-ALB” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K66613407H.**

Vlera: **26 890 636.50** (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) **lekë pa TVSH**

2. **Operatori Ekonomik: “NDERTIMI” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K11325002C.**

Vlera: **27 575 310** (njëzet e shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**

3. **Operatori Ekonomik: “NDREGJONI” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K31329048I.**

Vlera: **27 439 912.5** (njëzet e shtatë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë pikë pesë) **lekë pa TVSH**

#### **Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. **Operatori Ekonomik: “EURO-ALB” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K66613407H.**

2. **Operatori Ekonomik: “NDERTIMI” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K11325002C.**

#### ***Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:***

❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “EURO-ALB” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

**I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

*b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **14** (katërbëdhjetë) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:*

- *Teknik ndërtimi – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Murator – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Pllakashtrues – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Karpentier – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Hidraulik – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Hekurkthyes – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Saldator – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Mekanik – jo më pak se 2 (dy) punonjës*

*Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:*

<i>Nr.</i>	<i>Emër Mbiemër i punonjësit</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Nr. Amzës/ekuivalent i diplomës/certifikatës profesionale</i>	<i>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</i>	<i>Data e vlefshmërisë së certifikatës së Sigurimit Teknik</i>
1.					
2.					
etj					

\* *Krahas paraqitjes së tabelës me të dhënat e kërkuara, për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa për punonjës të teknik ndërtimi të paraqitet diploma e shkollës së mesme/profesionale, Certifikatë e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.*

*V.O- Dokumentacioni (Diplomat/ dëshmitë/ certifikatat) që nuk është lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe bëhen shkak për veprime të mëtejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, në Tabelën që përmban të dhënat e punonjësve të kërkuar konstatohet se:**
- **Për punonjës të specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (2-10, dhe 12-14) nuk jepen të dhënat për “Nr. Amzës/ekuivalent i diplomës/certifikatës profesionale” që disponojnë, por janë shënuar nr.personal të identitetit të tyre;**
  - **Për punonjës të specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (4, 9, 14 dhe 16) nuk jepen të dhënat për “Institucionin publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës”;**
  - **Për punonjës të specializuar/ kualifikuar të shënuar në tabelë me nr.rendor (2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, dhe 16) nuk jepen të dhënat për “Datën e vlefshmërisë së certifikatës së Sigurimit Teknik”.**

## **II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

### **2.3.9 (Makineri, Pajisje)**

- a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se, Seksionin C: **DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”** nuk është plotësuar saktë me të gjitha të dhënat që kërkohen, ku:

- Për mjetet: **“Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton”** me targa: AA439TP, dhe AA698KK, për të cilët keni deklaruar se i dispononi me qira, **nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin.**
- Për mjetet e kërkuar: **“Rrul vibrues për ngjeshje asfalti deri 8 ton, dhe Rrul vibrues gomë - hekur deri 7 ton”**, ky kusht nuk përmbushet nga ana Juaj, **pasi keni deklaruar Rrul minimum 8 ton, ndërsa kërkesa është për rrul deri në 8 ton, si dhe për mjetin tjetër keni deklaruar vetëm Rrul, pa paraqitur të dhënat e tij, si dhe nuk keni përcaktuar peshën e tij siç kërkohet në kriterin e DST-së.**
- Për mjetin: **“Autobetoniere kantieri”**, për të cilat keni deklaruar pronësinë me deklaratat doganore Nr. R 96477, dhe R 40962, **nuk janë paraqitur të dhënat e tyre, duke qënë se janë automjete të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik, ndërsa për Autobetonieret CO BETON me targa: AA065AE; AA829SR; AA513NR të deklaruara me qira, afati i kontratës së qirasë për disponimin e tyre nuk mbulon të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.**
- Për mjetin: **“Asfaltoshtruese”** me nr. shasie 867142, **nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin.**
- Për mjetin: **“Asfaltoshtruese”** të deklaruar me qira, për të cilën në deklaratë keni shënuar vetëm **“Nr.1234REP”** në çdo kolonë, **nuk jepen të dhënat e asfaltoshtruses, si dhe të dhënat e Kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin.**
- Për Makinerinë e vijëzimit të deklaruar **“Fat. Nr. R64544, dt.09.06.2017 (13.09.2022-13.09.2023)”** nuk keni deklaruar të dhënat e kontratës noteriale të nënshkruar me qiradhënësin.

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NDERTIMI” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1, gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:...

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;...”

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Formulari i Sigurimit të Ofertës.

**II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

**2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, të cilat duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- **ISO 14001** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **OHSAS 45001**(Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

▪ **Krahas Çertifikimeve të kërkuara më lart, referuar natyrës së punimeve objekt prokurimi, operatorët ekonomik duhet të disponojnë dhe Çertifikatat sipas standarteve ISO, të mëposhtme:**

- **ISO 39001** (Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor) e përditësuar
- **PAS 99** (Për sistemin e menaxhimit të integruar) ose ekuivalente me të;

*Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.*

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Çertifikata PAS 99 (Për sistemin e menaxhimit të integruar) ose ekuivalente me të;**

**III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

**2.3.5 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Shtylla metalike për ndriçim**
- **Ndriçues LED**
- **Bojë bikomponente**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

**1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.**

**2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.**

**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. **Çertifikatë/ Deklaratë konfirmëtimi CE/ Çertifikatat e cilësisë sipas standarteve ose Dëshmi të testeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specififikimet teknike dhe standartet e kërkuara.**

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për listën e mallrave/ materialeve.**

**IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

b) *Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **14 (katërbëdhjetë) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:***

- *Teknik ndërtimi – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Murator – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Pllakashtrues – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Karpentier – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Hidraulik – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Hekurkthyes – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Saldator – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Mekanik – jo më pak se 2 (dy) punonjës*

*Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:*

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër i punonjësit</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Nr. Amzës/ekuivalent i diplomës/çertifikatës profesionale</b>	<b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>Data e vlefshmërisë së certifikatës së Sigurimit Teknik</b>
1.					
2.					
etj					

*\* Krahas paraqitjes së tabelës me të dhënat e kërkuara, për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/çertifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa për punonjësin Teknik ndërtimi të paraqitet diploma e shkollës së mesme/ profesionale, Çertifikatë e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe*

*Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.*

*V.O- Dokumentacioni (Diplomat/ dëshmitë/ certifikatat) që nuk është lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe bëhen shkak për veprime të mëtejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Tabela me të dhënat e kërkuar, si dhe referuar deklarimeve në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8* për punonjësit e specializuar/ kualifikuar, rezulton se:**
  - **Nga 3 (tre) punonjës të kërkuar me specialitetin “Murator”, operatori ekonomik ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) punonjës me këtë specialitet;**
  - **Nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës të specializuar “Saldator” dhe 2 (dy) punonjës të specializuar/ kualifikuar “Mekanik”.**

**V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

*2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 3 (tre) shoferë të mjeteve të rënda, dhe 3 (tre) manovratorë (eskavatoristë/ automakinist), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:*

- *Kontratë pune të vlefshme,*
- *Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,*
- *Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon 3 (tre) shoferë të mjeteve të rënda.**

**VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

**2.3.9 (Makineri, Pajisje)**

a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;...*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, *Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8*, konstatohet se:**

- **Operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Minifadromë, 1 (një) Autobitumatriçe, 2 (dy) Kompaktor ngjeshës, 1 (një) Çekiç pneumatik, 1 (një) Makineri prerëse asfalti, dhe 1 (një) Semafor kantieri për punime në rrugë.**
- **Për mjetet e kërkuar: “Rrul vibrues gomë – hekur mbi 15 ton” (deklaruar në pronësi), “Rrul vibrues për ngjeshje asfalti deri 8 ton” (deklaruar me qira), dhe “Rrul vibrues gomë - hekur deri 7 ton” (deklaruar me qira), nuk është përcaktuar lloji (gomë/ cilindër) dhe pesha për secilin rul siç kërkohet në kriterin e DST-së.**

## **VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.10 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë “Njësi/ Fabrikë prodhimi Asfaltobeton”, në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (Kontrata Noteriale e Qerasë/ Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:*

- *Dokumentacioni që vërteton pronësinë (Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- *Leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (në përputhje me ligjin Nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar).*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e disponimit të “Njësisë/ Fabrikë prodhimi Asfaltobeton”.**

## **VIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.11/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.11 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën në lidhje me dakortësinë mbi mënyrën e financimit të objekt investimit.**



**IX. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

**2.3.12 Afati i kryerjes së punimeve:**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, operatori ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve objekt investimi.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**NDREGJONI**” Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Tiranë, TIRANE, Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8*, me numër Nipt-i: **K31329048I**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **27 439 912.5** (njëzet e shtatë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë pikë pesë) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**